



Më
 Dana 23-04-2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja individuale Kadrije Goga-Lubishtani, me sekretaren juridike Florije Jakupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale vjedhja nga nen. 325 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2408-3/16 të datës 13.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të prokurorit të shtetit Agim Kuka, të akuzuarit me datë 09.03.2018, shpall dhe publikisht komunikon, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga Shtimja rr. [REDACTED], i lindur me [REDACTED] në Prishtinë, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. Personal [REDACTED] gjendet në vuajtjen e dënimit në Burgun e Dubravës për veprë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 10.10.2016 rreth orës 13.00 në oborrin e xhamisë së madhe në rrugën “Latif Hasani”, në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, derisa i dëmtuari [REDACTED] ishte duke u falur, i pandehuri ka shfrytëzuar rastin dhe i ka marr biçikletën ngjyrë e kaltër, me ç’rast të njëjtit i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth njëqind e pesëdhjetë (njëqind e pesëdhjetë) €,

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata ne baze të neneve 4,7,17,21,41, 46,51 dhe 73 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së, shqipton:

SHQIPTON

DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 3/tre/muaj të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në rast se i akuzuari brenda 2/dy/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprën tjetër penale (koha e verifikimit), dhe

DHE DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200/dyqind/ euro, të cilat është i obliguar që të i paguan në afatin prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

I akuzuari obligohet që të paguaj në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumën prej 20 /njëzet/ Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30/tridhjetë/ Euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.2408-3/16 të datës 13.01.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR] për veprën penale vjedhja nga nen. 325 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 09.03.2017, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, dhe ka shtuar se ditën kritike ka kaluar në afërsi të xhamisë aty ka parë një biçikletë dhe të njëjtën e ka marrë dhe ia ka shitur një personi dhe më tutje për fatin e asaj biçiklete unë nuk di asgjë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit,
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjëseneve dhe vërtetimin mbi kthimin e sendeve të datës 03.11.2016, fotografive, si dhe mbrojtjes së të akuzuarit dhe deklaratën e të dëmtuarit të dhëna në procedurën paraprake dhe shkresave tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Me që i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja nga nen. 325 par. 1 të KPK-së

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i gjendjes së dobët ekonomike, sjelljen korrekte gjatë procedurës, sendi i vjedhur i është kthyer të dëmtuarit, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja dhe ate në afërsi të objektit fetar, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar me kusht si dhe dënimin me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 450-451 të KPPK-së, obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë /€ si dhe konform, nenit.39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036 në emër të Fondit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30€, të gjitha në afatin prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.70/17 me dt. 09.03.2018

Sekretare Juridike

F. Jakupi

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Kadrije Goga-Lubishtani



Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.

E108. 13.3.18

4